VENDIM
Nr.1311, datë 6.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1293, DATË 27.9.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007, PËR ÇËSHTJEN "DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1293, datë 27.9.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në rreshtin e tretë të pikës 6, fjalët "… nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale,…" hiqen.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

"7. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 3 të vendimit, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.".

3. Numri rendor 7 bëhet 8.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha